

V E N D I M
Nr.23 datë 9.1.1993

**PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË NGA
ADMINISTRATA SHTETËRORE E PUNËS**

Në zbatim të ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", ndryshuar me ligjin nr.7579, datë 2.7.1992, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe e të Përndjekurve Politikë, duke filluar nga data 1.1.1993, të organizojë shërbimin e pagesës së papunësisë në zyrat e punës, të emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë për rrethet që ajo vetë përcakton.

2. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe e të Përndjekurve Politikë të marrë masat e nevojshme për dokumentacionin financiar, sigurimin e mjeteve monetare dhe krijimin e kushteve të tjera për zbatimin e dispozitave ligjore të pagesave të papunësisë.

3. Këshillat e rretheve dhe bashkitë, brenda datës 15.2.1993, t'u sigurojnë zyrave të punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë mjediset e nevojshme për kryerjen e shërbimit të pagesave.

4. Zyrat e punës, të emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë, organet e tatimeve dhe ato të policisë financiare të bashkërendojnë kontrollin në zbatim të nenit 11 dhe 14 të ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", ndryshuar me ligjin nr.7579, datë 2.7.1992, me qëllim që të parandalohet dhënia e pagesave të papunësisë për punonjësit që punojnë me ose pa lejen e ushtrimit të veprimtarisë private.

5. Për kryerjen e shërbimit të pagesave, në organikën e zyrave të punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë shtohet një personel prej 162 punonjësish. Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë për vitin 1993 i shtohet në planin e Buxhetit të Shtetit një fond prej 18 milionë lekësh investime, 4 milionë lekësh fond page dhe 8 milionë lekësh shpenzime të tjera.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV.KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku